ALBANIAN

Commissioner General for Refugees and Stateless Persons

UDHËZUES PËR FEMIJËT E SHOQËRUAR NË PROCEDURËN E AZILIT NE BELGJIKË



Towards a more integrated migration policy, made possible by the AMIF

.be

Responsible publisher:
Dirk Van den Bulck,
Commissioner General for
Refugees and Stateless Persons

This brochure was published with the
support of AMIF, the European Asylum,
Migration and Integration Fund.

It is available in Albanian, Arabic, Dari, Dutch,
English, French, Pashto and Russian.

These different language versions
can be found on:

www.cgrs.be/en/publications

Version : May 2019

PËRMBAJTJA

MIRDITA 4

1 ÇFARË ËSHTË NJË KËRKESË PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE? 8
ÇFARË ËSHTË NJË KËRKESË PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE? 9

2 SI ZHVILLOHET PROCEDURA? 10
SI ZHVILLOHET PROCEDURA? 11
CILAT JANË VENDIMET E NDRYSHME TË MUNDSHME? 11

3 ÇFARË ËSHTË NJË REFUGJAT ? 12
ÇFARË ËSHTË NJË REFUGJAT ? 13
ÇFARË DO TË THOTË « MBROJTJE PLOTËSUESE »? 14
CILAT JANË TË DREJTAT SI FEMIJË NË KËTË PROCEDURË? 15

4 TI DO TË FLASËSH VETË/ SI T'JA BËSH 16
TI DO TË FLASËSH VETË/ SI T'JA BËSH? 17
A je gjithmonë i/e ftuar për një intervistë në qoftë se e ben kërkesën? 17
INTERVISTA ME NJË BASHKËPUNETOR TË CGRA? 18
Ku do të diskutosh me një bashkëpunëtor të CGRA? 18
Mbas bisedës me prindërit tuaj ose me kujdestarin tënd, është rradha jote 19
Si zhvillohet intervista me bashkëpunëtorin e CGRA? 20
Kush është prezent në intervistë? 20
Për çfarë do flasim gjatë kësaj interviste? 22
Është ky vendimi i cili ti dëshiron? 22
NJË INTERVISË E DYTË ËSHTË E MUNDUR 23
TI MERR NJË FTESË PËR INTERVISTË NË CGRA, POR TI NUK E KE KËRKUAR KËTË INTERVISTË 24
VENDIMI 25
INTERVISTA NË CGRA 26
SHEMBULL, LETRA ME KËRKESË PËR INTERVISTË 28

KONTAKTET 30

MIRDITA

Ti e merr këtë proshurë sepse prindërit tuaj ose kujdestari yt i ligjshëm ka kërkuar një mbrojtje ndërkombëtare në Belgique dhe ti i shoqëron ata.

Kujdestari i ligjshëm është një person që nuk është prindi yt por ai është i autorizuar nga autoritetet e vendit tënd të origjinës të kujdeset për ty.

Në këtë broshurë, ne do të shpjegojmë se çfarë do të thotë një mbrojtje ndërkombëtare **për ty**.

Prindërit tuaj ose kujdestari yt e marrin gjithashtu një broshurë e cila shpjegon se çfarë do të thotë kërkesa e tyre për një mbrojtje ndërkombëtare për ty.

Më shumë informata?

Ti mund të gjesh një përmbledhje të kësaj broshure në: www.cgrs.be/en/asylum/children-asylum-procedure

Gjithashtu, në faqen e internetit të CGRA, do të gjesh shumë informacione tjera mbi procedurat e azilit në Belgjikë.

Faqet interesante të internetit janë të shënuara me top të kaltërt.



PROCEDURA E AZILIT

REGJISTRIMI

INTERVISTA

PRITJA DHE SHOQËRIMI


VENDIMI
REFUGJAT I NJOHUR
MBROJTJA PLOTËSUESE
ANKESA

1

ÇFARË ËSHTË NJË KËRKESË PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE ?



ÇFARË ËSHTË NJË KËRKESË PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE?

Prindërit tuaj ose kujdestari yt kërkojnë një mbrojtje autoriteteve belge sepse kanë pasur probleme të rënda në shtetin tënd të origjinës ose kanë frikë të kenë probleme. Prandaj, prindërit tuaj ose kujdestari yt mendojnë që ti nuk mund të ktheheni në vendit tënd. Prindërit tuaj ose kujdestari yt kanë bërë këtë kërkesë në Zyren e të Huajve. Në qoftë se prindërit tuaj ose kujdestari yt nuk kanë bërë një kërkesë mbrojtjeje në një vënd tjetër, kërkesa i transferohet Komisariatit të Përgjithshëm të Refugjatëve dhe të Apatridëve (CGRA shkurt), i cili e shqyrton kërkesën e mbrojtjes ndërkombëtare. Komisariati (CGRA) i fton prindrit tuaj dhe kujdestarin tënd për një intervistë personale, që ato të shpjegojnë se përse kanë pasur probleme dhe pse kanë frikë të kenë. Intervista përsonale bën pjesë në atë që e quajmë e drejta për t'u dëgjuar.

2

SI ZHVILLOHET PROCEDURA ?

SI ZHVILLOHET PROCEDURA ?

Prindërit tuaj ose kujdestari yt duhet të shkojnë në fillim në Zyren e të Huajve, aty ku ti e ke marrë këtë broshurë, për të bërë një deklaratë. CGRA fton pastaj prindrit ose kujdestarin tënd për një intervistë personale. Bëhet fjalë për një intervistë në të cilën ju do ti shpjegoni bashkëpunuesit të CGRA për çfarë arsye/arsyesh e keni lënë vendin tuaj dhe perse nuk mund të ktheheni atje. Ky person shqyrton kërkesën e mbrojtjes ndërkombëtare të prindërve tuaj ose të kujdestarit tënd. Ai ju bën pyetje mbi arsyen/et që i ndalojnë të kthehen në vëndin tënd. **Prindërit tuaj ose kujdestari juaj e dinë më mirë se si ti mbrojnë të drejtat tuaja**. Kjo do të thotë që gjatë intervistës personale në CGRA, ato duhen gjithashtu të përmendin problemet që ti mund të kesh pasur eventualisht në vëndin tënd dhe përse nuk mund të kthehesh atje. Në bazë të deklaratave të tyre, CGRA do të marrë të njejtin vendim për ty dhe prindërit tuaj ose për kujdestarin tënd.

CILAT JANË VENDIMET E NDRYSHME TË MUNDSHME ?

Belgjika ofron dy forma mbrojtjeje : **statusin e refugjatit dhe statusin e mbrojtjes plotësuese**.

3

ÇFARË ËSHTË NJË REFUGJAT ?

ÇFARË ËSHTË NJË REFUGJAT?

Belgjika ka firmosur Konventen e Gjenevës. Bëhet fjalë për një traktat ndërkombëtar. Nëpërmjet firmës të këtij traktati, Belgjika është e detyruar të ofrojë një mbrojtje personave të cilët kanë frikë të kenë disa probleme me autoritetet ose me përsona të tjerë, në qoftë se kthehen në vendin e tyre.

Ti mund të kesh probleme për shumë arsye.

Për shkak të :

- Opinioneve tuaja politike ose të familjes tënde
- Fesë tënde
- Racës tënde
- Kombësisë tënde
- Përkatësisë tënde në ndonjë « grup shoqëror ». Fjala « grup shoqëror » do të thotë një grup personash të cilët kanë një pikë të përbashkët që është e pamundur ta ndryshojnë. Për shkak të këtyre elementeve, shumica e personave në shtetin tënd ose autoritetet vëndit tënd trajtojnë keq. Për shëmbull : vajzat që nuk mund të shkojë në shkollë vetëm se ato janë vajza.

e
të

ÇFARË DO TË THOTË « MBROJTJE PLOTËSUESE »?

Në qoftë se ti nuk merr statusin e refugjatit për shkak të situatës tënde, CGRA shqyrton kushtet e nevojshme për të marrë statusin e mbrojtjes plotësuese.

CGRA jep një mbrojtje plotësuese në qoftë se ti rrezikon realisht një cenim në rast se kthehesh në shtetin tënd.

Cenimet e rënda janë, për shëmbull :

- Dënimi me vdekje ose ekzekutimi,
- Tortura ose trajtime çnjerëzore ose degraduese,
- Një kërcënim i rëndë për jetën në rast lufte ose luftë civile.

Mbas shqyrtimit të kërkesës tuaj ndërkombëtare, CGRA mund të vendos :

- Dhenjen e një statusi të mbrojtjes ;
- Refuzimin e një statusi të mbrotjes.

CILAT JANË TË DREJTAT SI FEMIJË NË KËTË PROCEDURË ?

Të gjithë fëmijët kanë të drejta të veçanta, të cilat i quajmë të drejtat e fëmijës. Konventa është hartuar pikërisht për të drejtat e fëmijës që ato të mund ti ushtrojnë këto të drejta. Shumica e shteteve në botë, përfshij Belgjikës, e kanë firmosur këtë konventë dhe angazhohen kështu që fëmijët të përfitojnë efektivisht nga të drejtat e tyre.

Njëra nga të drejtat e fëmijës është e drejta e dëgjimit. Kjo do të thotë që ti ke të drejtë të shprehesh në kuadrin e një vendimi të rëndësishëm që të përket ty gjithashtu. Ti mund të shprehesh në menyrën që preferon : duke folur, duke vizatuar, duke shkruar ose në ndonjë menyrë tjetër. **Është një e drejtë, por nuk është një detyrë**. Pra, ti nuk je i/e detyruar ta bësh.

Prindërit tuaj ose kujdestari yt e dijnë më mirë se si ti mbrojnë interesat tuaja. Ti nuk shprehesh në qoftë se nuk do. Në qoftë se nuk preferon ta bësh, kjo nuk ka pasojë mbi vendimin e prindërve tuaj ose të kujdestarit tënd.

Ti nuk je i/e detyruar të shoqërosh prindërit tuaj ose kujdestarin tënd për intervisten në CGRA me bashkëpunëtorin e CGRA.

4

TI DO TË FLASËSH VETË/ SI T'JA BËSH

TI DO TË FLASËSH VETË/ SI T'JA BËSH?

Në qoftë se dëshiron të flasësh vetë, ti duhet të lajmërosh CGRA. Më e mira është që ti të shkruash një letër ose një e-mail, **jo më vonë se pesë ditë para intervistës personale të prindërve tuaj ose të kujdestarit tënd**. Ti nuk je i/e detyruar ta bësh vetëm, ti mund ti kërkosh ndihmë prindërve tuaj, një avokati, një mësuesi, një asistenti social, një personi të besueshëm, etj. Ti mund ti pyesësh dikë të telefonojë për ty në shërbimin e CGRA. Ti do ti gjesh të gjitha informacionet e kontaktit gjithashtu edhe një kopje të letrës në fund të broshurës.

A JE GJITHMONË I/E FTUAR PËR NJË INTERVISTË NË QOFTË SE E BEN KËRKESËN?

Jo.

Në qoftë se CGRA vlerëson që ti je shumë i ri për të shpjeguar arsyet e largimit nga vendi yt, ti do marrësh një letër për këtë temë. Në qoftë se CGRA vendos të bëj një intervistë me ty, do marresh gjithashtu një letër.

Aty caktohet vëndi dhe dita ku ju mund të diskutoni bashkë me një bashkëpunëtor të CGRA. Ti mundesh gjithashtu t'ja tregosh këtë letër shkollës, që ta justifikosh mungesën tënde atë ditë.

INTERVISTA ME NJE BASHKEPUNETOR TE CGRA?

KU DO TË DISKUTOSH ME NJË BASHKËPUNËTOR TË CGRA?



Në parim, ti shoqëron prindërit në CGRA dhe ti qëndron në sallën e pritjes deri sa bashkëpunëtori i CGRA të ketë mbaruar intervisten me prindërit tuaj ose me kujdestarin tënd. Një prind qëndron çdo herë me ty derisa prindi tjetër të tregojë historinë bashkëpunëtorit të CGRA. Në qoftë se je i/e shoqëruar veç nga një prind ose një kujdestar në Belgjikë, mund të presësh në sallën e pritjes ose përpara lokalit ku prindi yt ose kujdestori yt ka intervisten e tij përsonale. Meqë intervista me prindërit tuaj ose me kujdestarin tënd mund të zgjasi disa orë, është e preferuar që të sillni ndonje gjë me vehte dhe të merreni me diçka gjatë kohës së pritjes.

MBAS BISEDËS ME PRINDËRIT TUAJ OSE ME KUJDESTARIN TËND, ËSHTË RRADHA JOTE

Mbas bisedës me prindërit tuaj ose me kujdestarin tënd, është rradha jote. Bashkëpunëtori i CGRA vjen e të merr në sallën e pritjes ose në koridor dhe të sjell në zyren ku zhvillohet intervista. Ti je i/e ulur, bashkë me bashkëpunëtorin e CGRA, në një zyre në të cilën gjendet një kopjuter. Gjatë kësaj interviste, ti mund të shpjegosh, në të gjitha mënyrat e mundshme se përse e kë lënë vëndin tënd dhe përse mendon që nuk mund të kthehesh në vëndin tënd : ti mund të tregosh, mund të vizatosh ose mund të përdorësh figura Duplo për ti përshkruar problemet e tua. Bashkëpunëtori i CGRA do të ndihmojë aq sa të jetë e mundur, që CGRA të kuptojë mirë se cilat janë problemet tuaja.

Në raste të rradha, është e mundur që mos të kesh intervistë me një bashkëpunëtor të CGRA të njejtën ditë me prindërit tuaj ose kujdestarin tënd, për shëmbull, ngaqë ke vëllezër et motra që duan të flasin gjithashtu ose ngaqë intervista e prindërve ose të kujdestarit tënd ka zgjatur shumë. Intervista jote zhvillohet atëherë një ditë tjetër. Do marrësh një letër në të cilën është e caktuar data se kur mund të shprehesh.

SI ZHVILLOHET INTERVISTA ME BASHKËPUNËTORIN E CGRA?

Edhe në qoftë se duhet të presësh një kohë përpara se të flasësh me një bashkëpunëtor të CGRA, intervista jote nuk zgjat shumë në përgjithësi. Kjo zgjat zakonisht një gjysëm ore të vogël. Është normale që të jesh pak nervoz/e. Bashkëpunëtori i CGRA do të dëgjoj. Ti mund t'ja tregosh atij të gjitha përsa i përket arsyes/ve që të kanë detyruar të lëshosh vendin tënd. Në qoftë se do mbash gjëra për vehte, e ke të drejtën ta bësh. Është e mundur që bashkëpunëtori i CGRA të bëjë disa pyetje që ti kuptojë mirë të gjitha. Të jesh i ndershëm dhe thuaj atë që di. Nuk je i/e detyruar ti përgjigjesh të gjitha pyetjeve, ska asgjë të keqe. Atë që i tregon bashkëpunëtorit të CGRA, nuk ju komunikohet përsonave të shtetit tënd.

KUSH ËSHTË PREZENT NË INTERVISTË?

Gjatë intervisës me bashkëpunëtorin e CGRA, një person është prezent dhe ai përkthen atë që ti thua. Është përkthyesi, i cili kujdeset që ju të kuptoheni mirë. Përkthyesi është neutral, kjo do të thotë që ai nuk i tregon asgjë prindërve tuaj ose përsonave të tjerë në lidhje me atë që ke treguar gjatë kësaj interviste. Përkthyesi nuk ndërhyn në vendimin e prindërve tuaj, të kujdestarit tënd ose në vendimin tënd. Ti mund të marrësh në intervistë **vetëm një person në të cilin ke besim dhe që ai nëpërmjet profesionit të tij ka një lidhje me ty**. Mund të jetë për shëmbull mësuesja jote, një asistent(e) social(e). Kujdes, ai nuk duhet të jetë mami yt, babi yt ose kujdestari yt. Është e preferuar që të shënini në letrën tuaj ose në e-mailin tuaj të adresuar CGRA se ke do merrni me vehte në intervistë. Personi që të shoqëron është aty veç për të përkrahur dhe për të ndihmuar. Kujdes, është e mundur që



bashkëpunëtori i CGRA të mendojë që ky person nuk është i aftë të të përkrahë ose ai nuk i plotëson kushtet për të marrë pjesë në intervistë. Bashkëpunuesi i CGRA ateherë mund të vendos që të mos autorizojë këtë person për të marrë pjesë në intervistë. Përsoni që të shoqëron nuk mund të bëjë deklarata në emrin tënd. Mbi të gjitha, je ti ai/ajo që ke fjalën tënde për të thënë !

Gjatë intervisës, ti duhet të shoqërohesh nga një avokat. Mund të jetë i njejti avokat si i prindërve. Avokati yt i përmbahet sekretit profesional. Atë që ti diskuton me të është konfidenciale dhe nuk mund ti raportohet askujt, as prindërve tuaj në qoftë se ti nuk dëshiron.

Personi i besueshëm dhe avokati mund të bëjnë vërejtje në fund të intervistës.

PËR ÇFARË DO FLASIM GJATË KËSAJ INTERVISTE?

Aty do flasim veç për **situatën tënde**. Problemet e prindërve tuaj, të kujdestarit tënd ose të anëtarëve të familjes nuk përmenden gjatë kesaj interviste. Prindërit tuaj ose kujdestari yt i kanë parashtruar problement e tyre tek bashkëpunëtori i CGRA. Pra, ne flasim veç për arsyen/arsyet që të kanë detyruar ta lëshosh vëndin tënd ose arsyen/arsyet që të ndalojnë të kthehesh në vendin tënd. Të gjitha fjalët e tua shënohen në kopjuter nga një bashkëpunëtor i CGRA dhe bashkangjiten me dosjen e prindërve ose të kujdestarit tënd.

ËSHTË KY VENDIMI I CILI TI DËSHIRON?

Jo.

CGRA është i lidhur me rregulla dhe kushte ligjore gjatë dhënjes së statusit të mbrojtjes. Bashkëpunëtori i CGRA të dëgjon dhe i analizon elementet për të cilat ti ke folur. Bashkëpunëtori i CGRA proposon një vendim në basë të gjitha informacioneve që ai ka marrë. Deklaratat e prindërve ose të kujdestarit tënd janë më të rëndesishme për vlerësimin e kërkesës tënde të mbrojtjes ndërkombëtare. Nisemi nga parimi që prindërit tuaj ose kujdestari yt mbrojnë gjithashtu interesat tuaja dhe përmendin probleme eventuale që ti ke dhe mund të kesh. Prandaj, një vendim i ndryshëm mund te merret nga ai që ti dëshiron.

NJË INTERVISË E DYTË ËSHTË E MUNDUR

Ti mund të kesh një ose shumë arsye të **tjera** nga ato të prindërve ose të kujdestarit tënd që të ndalojnë të kthehesh në vendin tënd. Ndodh shumë radhe. Në qoftë se rastet që ti parashtron duken shumë të rënda, ti mund të marrësh një letër tjetër ku ftohesh për një intervistë të dytë në CGRA. Prindërit ose kujdestari yt prap nuk mund të jenë prezent. Një avokat merr pjesë gjatë intervistës tënde dhe ti mund të marrësh një person në të cilin ke besim. **Në rast se ti jep deklarata të kundërta me ato të prindërve, ato nuk do t'ju komunikohen prindërve ose të përdoren kundra tyre**, që ti të mund të tregosh atë që do në liri të plotë dhe me sinçeritet.

Pra, të gjitha ato që ti thua do të jenë konfidenciale.

Veç avokati yt mund ti lexojë mevonë deklaratat tuaja.

TI MERR NJË FTESË PËR INTERVISTË NË CGRA, POR TI NUK E KE KËRKUAR KËTË INTERVISTË

Ndodh nganjëherë që CGRA vendos mbas intervistës me prindërit ose me kujdestarin tënd, që është e nevojshme të japim mundësinë që ti të shpjegosh atë që ka ndodhur në vëndin tënd dhe përse nuk mund të kthehesh atje. Ti merr një letër ftesë atëherë për një intervistë në CGRA. Gjatë kësaj interviste, ti duhet të kesh një avokat ose eventualisht një person të besueshëm. Prindërit tuaj ose kujdestari yt mund të shoqërojnë në CGRA, **por ata nuk mund marrin pjesë në intervistë**. Ti nuk je i/e detyruar ti përgjigjesh kësaj ftese. Në qoftë se nuk preferon ta bësh, kjo nuk do të ketë asnjë pasojë për vendimin e prindërve ose të kujdestarit tënd.

Më shumë informata?

TË GJITHA INFORMATAT RRETH INTERVISTËS

Mund ta gjeni në faqen e internetit :

https://www.cgrs.be/en/international-protection/interview

VENDIMI

Mbasi që bashkëpunuesi i CGRA të ketë mbledhur të gjitha informacionet e nevojshme, ndër të cilat deklaratat e tua dhe ato të prindërve tuaj ose të kujdestarit tënd, ai prezanton vendimin e tij. Mund të bëhet fjalë për një vendim të vetëm për ty dhe prindërit tuaj ose kujdestarin tënd, por nganjëherë është e mundur që ti të marrësh një vendim të ndryshëm në qoftë se është në interesin tënd. Në qoftë se prindrit tuaj, kujdestari yt ose ti nuk jeni dakord me vendimin, ti mund të bësh ankesë kundra këtij vendimi. Është e preferuar që të diskutosh me avokatin tënd.



Më shumë informata?

TË GJITHA INFORMATAT PËR VENDIMIN

Mund ta gjeni në faqen e internetit :

https://www.cgrs.be/en/international-protection/the-decision

INTERVISTA NË CGRA : DY MUNDËSI :

1

TI KE DESHIRE TE SHPREHESH

NUK ËSHTË DETYRUAR

PRINDËRIT OSE KUJDESTARI **NUK** JANË PREZENT GJATË INTERVISTËS

I/E SHOQËRUAR NGA :

AVOKATI

PERSON I BESUESHËM EVENTUALISHT

INTERVISTË **E SHKURTËR**

NUK JANË PËRDORUR DEKLARATA TË KUNDËRTA ME ATO TË PRINDËRVE

NJË VENDIM I VETËM DHE I NJËJTI PËR FAMILJEN

2

CGRA TE FTON PER INTERVISTE

NUK ËSHTË DETYRUAR

PRINDËRIT OSE KUJDESTARI **NUK** JANË PREZENT GJATË INTERVISTËS

I/E SHOQËRUAR NGA :

INTERVISTË MË E **GJATË**, ME PYETJE OBJEKTIVE

NUK JANË PËRDORUR DEKLARATA TË KUNDËRTA ME ATO TË PRINDËRVE

AVOKATI

PERSON I BESUESHËM EVENTUALISHT

NJË VENDIM I VETËM DHE I NJËJTI PËR FAMILJEN*

***një mundësi e veçantë për një vendim individual**

SHEMBULL, LETRA ME KËRKESË PËR INTERVISTË

Request to be heard from an accompanied child

Dear Madam, Sir,

My name is (name of the child:) ..... and I am (age:) ..... years old.

My parent(s) or guardian is/are (name of parent/s or guardian): .....

I came to Belgium with my parent(s) or guardian.

We lived in (country of origin): .....

I would like to tell you in person what I find important and why I cannot go back to my country. I know I have to go to the CGRS for this.

SP/OV number of parent(s) or guardian:

.....

signature

Kontaktet

COMMISSIONER GENERAL FOR REFUGEES AND STATELESS PERSONS

Rue Ernest Blerot 39
1070 ANDERLECHT
Telefon +32 (0)2 205 51 11
Faks +32 (0)2 205 51 15
E-mail: cgvs.info@ibz.fgov.be
Faqja e internetit: www.cgvs.be

CELULA PËR TË MITURIT

CGRA ka një kordinatore për azilkërkuesit e mitur.

Ajo është e informuar për çdo gjë në lidhje me trajtimin e kërkesave për azil për fëmijët e mitur nën mbikëqyrje. Ajo ndjek nga afër dosjet e tyre.

Për çdo pyetje ose vërejtje, prindërit dhe kujdestarët mund t'i drejtohen kordinatores për të miturit.

E-mail: CGRA-CGVS.Mineurs@ibz.fgov.be

Telefon +32 (0)2 205 53 06
Faks +32 (0)2 205 50 05

Si instancë qendrore dhe e pavarur për azil, CGRA është në kontakt me shumë partnerë belg, evropianë dhe ndërkombëtarë.

Lexo më shumë në : www.cgrs.be/en/partners

Dëshiron të dish më shumë rreth CGRA?

Më shumë informacione mund të gjesh në : **www.cgrs.be**

Commissioner General for Refugees and Stateless Persons

Rue Ernest Blerot 39, 1070 ANDERLECHT

cgvs.info@ibz.fgov.be T +32 2 205 51 11

www.cgrs.be F +32 2 205 51 15

Towards a more integrated migration policy, made possible by the AMIF